

VENDIM
Nr.469, datë 31.7.2025

**PËR EMËRIMIN E TRE ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR TË
PËRZGJEDHJES PËR TND-NË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin, si anëtarë të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në, të:
 - a) z. Aleksandër Xhuvani për një mandat 5-vjeçar, duke filluar nga data 28.8.2025;
 - b) znj. Eglantina Zyka për një mandat 5-vjeçar, duke filluar nga data 28.8.2025;
 - c) znj. Klesta Hysi, e cila do të qëndrojë në detyrë deri në datën 19.1.2027, datë në të cilën përfundon mandati i ish-anëtarit të KKP-së, z. Erind Mërkuri.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku